

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projekt ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, të ndryshuar”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hedhur projektligjin e propozuar në faqen e regjistrimit elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJK <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/537>), më datë 27.10.2022 duke i dhënë mundësi publikut, grupeve të interesit dhe komunitetit të biznesit të shprehin mendimet e tyre. Ky njoftim ka ndejtur l afishuar në faqen zyrtare të konsultimit publik deri më datë 17 mars 2023.

Ndërkohë që MTM i është drejtuar edhe me shkresë zyrtare nr. 8314 prot, datë 11.11.2022, gjashtëdhjetë e një (61) bashkive të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin e tyre mbi këtë projektligj dhe ndryshimet ligjore të këtij propozimi.

Gjithashtu, duke qënë se projektligji lidhet me menaxhimin dhe vlerësimin e zhurmës në mjedis dhe prek një sërë aktorësh, si pushtetin vendor, qytetarët, bizneset, turizmin, etj., MTM ka organizuar dhe dëgjuesën publike me grupet e interesit pranë ambienteve të ministrisë në datë 16.1.2023, ora 10.00, ku u diskutua nga të pranishmit projektligji, synimet dhe objektivat e tij. Komentet dhe sugjerimet e tyre u trajtuan dhe reflektuan në draftin e projektligjit, të konsoliduar, ku u vu theksi kryesisht për marrjen e masave mbrojtëse nga niveli i lartë të zhurmës mbi atë kufi të lejuar në zonat turistike në bregdet. Ky takim, u kryesua nga zëvendësministrja e Turizmit dhe Mjedisit, Znj. Almira Xhembulla. Pas diskutimeve të shumta, përfaqësuesit e grupeve të interesit, dhanë komentet e tyre respektive (sipas materialit “Minuta – Takimi”, të cilin e gjeni bashkëlidhur). Në përfundim të takimit, znj. Xhembulla u mundësoi pjesëmarrësve dërgimin e komenteve të tyre, edhe në formë elektronike nëpërmjet adresës info@turizmi.gov.al, duke lënë afat datën 20.01.2023 (ditë e premtë).

3. Metoda e konsultimit

Për këtë projekt ligj janë ndjekur 3 metoda konsultimi:

1. Konsultimet elektronike – projekt ligji është publikuar në faqen zyrtare të konsultimit publik nga data 27 tetor 2022 deri me 17 mars 2023, (RENJK <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/537>;
2. Konsultime në formë shkresore – projekt ligji ju dërgua paraprakisht njësive të vetqeverisjes vendore (61 bashkive) për mendim;
3. Takimet publike – në ambjentet e Ministrisë është organizuar më datë 16 janar 2023 dëgjesa publike me palët e interesuara, palët u ftuan për pjesëmarrje nëpërmjet postës elektronike;

4. Palët e interesit të përfshira

Referuar ligjit kuadër nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, u njoftuan për të marr pjesë nga fusha e turizmit, Unioni Turistik Shqiptar i përfaqësuar nga disa subjekte, si dhe grupet e interesit nga fusha e mjedisit:

- REC Albania

- PPNEA (Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojten e Mjedisit Natyror në Shqipëri)
- Qendra Eden
- Eko Lëvizja
- Eco- Albania
- Instituti i Studimeve Ambientale, Tiranë
- Milleucontact Albania

Gjithashtu, Për të realizuar këtë process MTM, me mbështetjen e projektit SANE27 – faza II, ka bërë fillimisht analizën e vlerësimit të mangësive ligjore, nëpërmjet të cilës u identifikuan ndërhyrjet që duheshin ndërmarrë. Në kuadër të këtij propozimi, për hartimin e këtij projektligji kanë kontribuar ekspertë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ekspertë të projektit SANE27, faza II, si dhe të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuarra me arsyetimin e komenteve të pranuarra/ refuzuara

Grupet e interesit e mbështetën nismën për qartësimin e kompetencave duke përfshirë bashkitë në procesin e kontrollit, si autoritete kompetente brenda territorit të së cilës ushtrohen këto veprimtari.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hedhur projektligjin e propozuar në faqen e regjistrimit elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik (RENJK <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/537>), më datë 27.10.2022 duke i dhënë mundësi publikut, grupeve të interesit dhe komunitetit të biznesit të shprehin mendimet e tyre. Ky njoftim ka qenë i afishuar në faqen zyrtare të konsultimit publik deri më datë 17 mars 2023. Nuk ka patur asnjë koment të ardhur për këtë projekt ligj.

Ndërkohë që MTM i është drejtuar edhe me shkresë zyrtare nr. 8314 prot, datë 11.11.2022, gjashtëdhjetë e një (61) bashkive të Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin e tyre mbi këtë projektligj dhe ndryshimet ligjore të këtij propozimi. Komentet e disa bashkive, përkatësisht Bashkisë Patos dhe Bashkisë Shkodër. janë marrë në konsideratë që lidhen kryesisht me përcaktimin dhe ndarjen e qartë të detyrave të inspektimit të strukturave pranë AKM/ARM dhe atyre të inspektimit në Bashki. Bashkia Maliq është shprehur parimisht dakord dhe pa komente, ndërsa bashkitë e tjera nuk kanë sjellë mendim. Komentet e bashkive kanë ardhur edhe nëpërmjet Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore.

Lidhur me komentet e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore, të përcjella nëpërmjet Vendimit nr. 2, datë 6.3.2023, sqarojmë se:

Referuar komentit për qartësimin e mënyrës së bashkëpunimit/ndërveprimit /raportimit midis bashkisë dhe autoritetit qendror përgjegjës, me qëllim shmangien e mbivendosjeve të kompetencave, sqarojmë se neni 4 dhe neni 6 i projektligjit përcaktojnë në mënyrë të qartë kompetencat për secilin pushtet. Gjithashtu, edhe në nenin 10 të projektligjit, i cili ndryshon nenin 20 të ligjit bazë, janë qartësuar detyrimet e bashkisë për raportimin.

Për komentin mbi saktësimin e termit “Ministria” në ministria përgjegjëse për çështjet e mjedisit, sqarojmë se ky përkufizim është dhënë në ligjin bazë, nenin 3, pika 19 dhe nuk ka nevojë të përsëritet në tekstin e projektligjit.

Për komentin që projektligji nuk përcakton /liston kategoritë apo subjektete e posaçme që duhet të pajisen me leje mjedisi, sqarojmë se këto parashikime janë përcaktuar në shtojcën 1, të ligjit Nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

Referuar komentit që neni 8/2 nuk përcakton kategoritë e personave fizikë apo juridikë që nuk përfshihen në nenin 12, pika 1 e ligjit, sqarojmë se kjo dispozitë është riformuluar duke mbajtur në konsideratë mendimin e Ministrisë së Drejtësisë. Për rrjedhojë është shtuar pika 3, e cila parashikon si kriter për pajisjen me vërtetim ato veprimtari që zhvillohen në zona apo qendra të banuara dhe në zonat turistike, të cilat lëshojnë zhurmë dhe nuk përfshihen në listën e veprimtarive sipas ligjit për lejet e mjedisit. Lista e veprimtarive që lëshojnë zhurmë në mjedis dhe kanë detyrimin për pajisje me vërtetim, si dhe formati i vërtetimit do të miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit. Pra, është parashikuar të nxirret një akt nënligjor për të përcaktuar se për cilat veprimtari, personat fizikë/juridikë do të kenë detyrimin për tu pajisur me vërtetim.

Për komentin që detyrimi i bashkisë për raportimin e zbatimit të planit të jetë të jetë në fund të vitit, u reflektua në pikën 7, të nenit 10 të projektligjit.

Komenti që neni 13 nuk është përcaktuar ndarja midis aktiviteteve që mund të kontrollohen nga pushteti qendror dhe vendor, nuk qëndron pasi ndarja e aktiviteteve është bërë sipas llojit të veprimtarisë për të cilën lëshohet leje mjedisi që monitorohet nga AKM dhe vërtetim, që monitorohet nga strukturat përgjegjëse të kontrollit në bashki. Kjo është e qartësuar edhe tek neni 8 i projektligjit nëpërmjet shtimit të pikës 3.

Sa i përket komentit që të parashikohet detyrimi për pajisjen e Policisë bashkiake me aparat për matjen e nivelit të zhurmave të certifikuara nga organet përkatëse, sqarojmë se në nenin 6 të projektligjit germa “d”, është parashikuar që bashkia është përgjegjëse për marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit, nga veprimtaritë ekonomike apo sociale që lëshojnë zhurma brenda juridiksionit të saj, nëpërmjet kontrollit me pajisje të certifikuara për matjen e niveleve të zhurmës, të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që lëshojnë zhurmë.

Lidhur për komentin që të shtohet një dispozitë mbi përcaktimin e një tarife për lëshimin e vërtetimit, nga Këshilli Bashkiak, sqarojmë se vendosja e tarifave në këtë projektligj nuk është parashikuar, pasi kjo kompetencë e Këshillit Bashkiak është parashikuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 54, shkronja “f”. Ndërkohë sugjerimi për pezullimin e veprimtarisë në rast të mosplotësimit të kushteve të këtij projektligji, pas kalimit të afatit 1 vjeçar, u mor në konsideratë dhe u reflektua në nenin 19 të projektligjit.

MTM ka organizuar dhe dëgjesën publike me grupet e interesit pranë ambienteve të ministrisë në datë 16.1.2023, ora 10.00, ku u diskutua nga të pranishmit projektligji, synimet dhe objektivat e tij. Komentet dhe sugjerimet e tyre u trajtuan dhe reflektuan në draftin e projektligjit, të konsoliduar, ku u vu theksi kryesisht për marrjen e masave mbrojtëse nga niveli i lartë të zhurmës mbi atë kufi të lejuar në zonat turistike në bregdet, si dhe në harmonizimin e planeve të menaxhimit të zhurmave me PPV-në e secilës bashki. Theksi u vendos edhe tek afati kohor i hartimit të planeve vendore të veprimtari për zhurmat dhe bazuar në diskutime u dakordësua që këto plane të hartohen 1 vit pas përgatitjes së hartave strategjike të zhurmës. Reflektimi u pasqyrua në nenin 10, pika 1 e projektligjit. Në përfundim të takimit ju mundësua pjesëmarrësve dërgimi i komenteve të tyre, edhe në formë elektronike nëpërmjet adresës info@turizmi.gov.al, duke lënë afat datën 20.01.2023 (ditë e premtje). Në adresën elektronike nuk u paraqit asnjë koment tjetër brenda datës së caktuar për këtë projekt – ligj.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi

		mënyrë të ngjashme)		
<i>Hartimi të planeve vendore të veprimt për zhurmat.</i>	<i>U dakordësua që këto plane të hartohen 1 vit pas përgatitjes së hartave strategjike të zhurmës, duke mbajtur në konsideratë Planin e Përgjithshëm Vendor.</i>	<i>Unioni Turistik Shqiptar i përfaqësuar nga disa subjekte, si dhe grupet e interesit nga fusha e mjedisit</i>	<i>Reflektimi u pasqyrua në nenin 10, pika 1 e projektligjit.</i>	
<i>Qartësim i institucionit që ka përgjegjësinë për marrjen e masës administrative</i>	<i>Duhet të ketë një qartësim përsa i përket nenit 32 “Kundërvajtjet administrative”</i>	<i>Bashkia Patos</i>	<i>U refuzua</i>	<i>Në nenin 16 të projektligjit janë bërë ndryshime të nenit 32 të ligjit ekzistues, ku janë ndarë qartë rastet e marrjes së masave administrative në rastet kur merren nga AKM/ARM apo nga NJVV-ja</i>
<i>Përcaktimi i kushteve teknike që duhet të plotësohen për pajisjen me Vërtetim</i>	<i>Të përcaktohen qartë “kushtet teknike” mbi bazën e të cilit do të lëshohen vërtetimi si dhe formati i Vërtetimit</i>	<i>Bashkia Shkodër</i>	<i>U pranua pjesërisht. Kushtet teknike janë të përcaktuara në Udhëzimi nr. 2 “Për treguesit, metodat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike të metodologjisë për vlerësimin</i>	

			<p>e niveli i zhurmës, dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për zgjidhjen dhe përmirësimin e situatës” miratuar në vitin 2013;</p> <p>Formati i vërtetimit do të miratohen me akt nënligjor të Këshillit të Ministrave, u reflektua në nenin 19 të projektligjit.</p>	
<p><i>Certifikimi i pajisjeve për monitorimin e zhurmave</i></p>	<p><i>Të përcaktohet tipi I pajisjes që do të përdoret si dhe certifikimi</i></p>	<p><i>Bashkia Shkodër</i></p>	<p><i>U refuzua</i></p>	<p><i>Matja apo vlerësimi i zhurmës vetëm nga organe të akredituara, që të jenë në përputhje me S SH ISO/IEC 17025 “Kërkesa të Përgjithshme për Kompetencën e Laboratorëve Testues dhe Kalibrues” dhe SSH EN ISO/DIS 1996 “Akustika Përshkrimi, matja dhe vlerësimi i zhurmës mjedisore - Pjesa 2: Përcaktimi i niveleve të</i></p>

				<p>presionit të zërit".</p> <p><i>Pra pajisjet dhe procedura përcaktohet nga Drejtoria e përgjithshme e Akdreditimit dhe standartet e sipërcituara.</i></p>
<p><i>Përcaktimi i veprimtarive që përfitojnë leje mjedisi si dhe ata që përfitojnë vërtetim.</i></p>	<p><i>Të përcaktohen qartë aktivitetet të cilat duhet të pajisen me lejen mjedisi ose aktivitetet që duhet të pajisen me vërtetim.</i></p>	<p><i>Bashkia Shkodër</i></p>	<p><i>U reflektua në nenin 19 të projektligjit.</i></p> <p><i>Lista e veprimtarive që lëshojnë zhurmë në mjedis dhe kanë detyrimin për pajisje me vërtetim, si dhe formati i vërtetimit do të miratohen me akt nënligjor të Këshillit të Ministrave.</i></p> <p><i>Konkretisht, sqarojmë se veprimtaritë që pajisen me leje mjedisi dhe që gjenerojnë zhurmë janë të përcaktuara shprehimisht në shtojcën 1, të ligjit 10448/2011 "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe neni 12 i</i></p>	

			<i>ligjit bazë të zhurmave nr.9774/2007, referon lejet e mjedisit</i>	
<i>Qartësimin e mënyrës së bashkëpunimit/ndërveprimit /raportimit midis bashkisë dhe autoritetit qendror përgjegjës, me qëllim shmangien e mbivendosjeve të kompetencave</i>	<i>Të parashikohet qartë mënyra e bashkëpunimit/ ndërveprimit/ raportimit midis bashkisë dhe autoritetit qendror përgjegjës me qëllim shmangien e mbivendosjeve lidhur me kompetencat specifike të secilit autoritet</i>	<i>Këshilli Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore</i>	<i>U refuzua</i>	<i>Sqarojmë se neni 4 dhe neni 6 i projektligjit përcaktojnë në mënyrë të qartë kompetencat për secilin pushtet. Gjithashtu, edhe në nenin 10 të projektligjit, i cili ndryshon nenin 20 të ligjit bazë, janë qartësuar detyrimet e bashkisë për raportimin.</i>
<i>Saktësim terminologjie</i>	<i>Saktësim i termit “Ministria” në “ministra përgjegjëse për çështjet e mjedisit”</i>	<i>Këshilli Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore</i>	<i>U refuzua</i>	<i>Sqarojmë se ky përkufizim është dhënë në ligjin bazë, nenin 3, pika 19 dhe nuk ka nevojë të përsëritet në tekstin e projektligjit.</i>
<i>Përcaktimi i listës së verprimtarive që pajisen me leje mjedisi</i>	<i>Projektligji nuk përcakton /liston kategoritë apo subjektete e posaçme që duhet të pajisen me leje mjedisi,</i>	<i>Këshilli Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore</i>	<i>U refuzua</i>	<i>sqarojmë se këto parashikime janë përcaktuar në shtojcën 1, të ligjit Nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.</i>

<p><i>Përcaktimi i aktiviteteve që pajisen me Vërtetim</i></p>	<p><i>Në nenin 8/2 nuk përcakton kategoritë e personave fizikë apo juridikë që nuk përfshihen në nenin 12, pika 1 e ligjit</i></p>	<p><i>Këshilli Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore</i></p>	<p><i>U reflektua pjesërisht në nenin 8, pika 3</i></p>	<p><i>Sqarojmë se kjo dispozitë është riformuluar duke mbajtur në konsideratë mendimin e Ministrisë së Drejtësisë. Për rrjedhojë është shtuar pika 3. Lista e veprimtarive që lëshojnë zhurmë në mjedis dhe kanë detyrimin për pajisje me vërtetim, si dhe formati i vërtetimit do të miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.</i></p>
<p><i>Detyrimi i raportimit për zbatimin e planeve vendore</i></p>	<p><i>Të përcaktohet detyrimi i bashkisë për raportimin e zbatimit të planit të jetë të jetë në fund të vitit</i></p>	<p><i>Këshilli Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore</i></p>	<p><i>u reflektua në pikën 7, të nenit 10 të projektligjit.</i></p>	
<p><i>Qartësim i institucionit që ka përgjegjësinë për marrjen e masës administrative</i></p>	<p><i>Në nenin 13 nuk është përcaktuar ndarja midis aktiviteteve që mund të kontrollohen nga pushteti qendror dhe vendor.</i></p>	<p><i>Këshilli Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore</i></p>	<p><i>U refuzua</i></p>	<p><i>Sqarojmë se ndarja e aktiviteteve është bërë sipas llojit të veprimtarisë për të cilën lëshohet leje mjedisi që monitorohet nga AKM dhe vërtetim, që monitorohet</i></p>

				nga strukturat përgjegjëse të kontrollit në bashki. Kjo është e qartësuar edhe tek neni 8 i projektligjit nëpërmjet shtimit të pikës 3.
<i>Pajisjet e certifikuara për matjen dhe monitorimin e zhurmës</i>	<i>Të parashikohet detyrimi për pajisjen e Policisë bashkiake me aparat për matjen e nivelit të zhurmave të certifikuara nga organet përkatëse.</i>	<i>Këshilli Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore</i>	<i>U refuzua</i>	<i>Sqarojmë se në nenin 6 të projektligjit gërma “d”, është parashikuar që bashkia është përgjegjëse për marrjen e masave për mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit, nga veprimtaritë ekonomike apo sociale që lëshojnë zhurma brenda juridiksionit të saj, nëpërmjet kontrollit me pajisje të certifikuara për matjen e niveleve të zhurmës, të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që lëshojnë zhurmë.</i>
<i>Përcaktimi i tarifës për lëshimin e Vërtetimit</i>	<i>Të shtohet një dispozitë mbi përcaktimin e një</i>	<i>Këshilli Konsultativ të Qeverisjes</i>	<i>U refuzua</i>	<i>Sqarojmë se vendosja e tarifave në</i>

	<i>tarife për lëshimin e vërtetimit, nga Këshilli Bashkiak</i>	<i>Qendrore me Vetqeverisjen Vendore</i>		<i>këtë projektligj nuk është parashikuar, pasi kjo kompetencë e Këshillit Bashkiak është parashikuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 54, shkronja “f”.</i>
<i>Për vendosje afati njëvjeçar në rast mos plotësimi të kërkesave të ligjit</i>	<i>Në nenin 8, pika 3 të shiktohet togëfjalëshi “Me kalimin e afatit njëvjeçar, subjekti që nuk ka plotësuar kërkesat e ligjit, aktiviteti i tij pezullohet, deri në plotësimin e kërkesave për nivelin e lejuar të zhurmave”</i>	<i>Këshilli Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetqeverisjen Vendore</i>	<i>U reflektua në nenin 19 të projektligjit.</i>	